

Në bazë të dispozitave të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe Vendimit nr.225/2025 Ndermarrja Publike Lokale NPL "EKO-SIG" SH.A, me dt.15.09.2025 shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita : Ndhimes-Elektricitist (1) vende të lira :

Kohëzgjatja: periudhë provuese 6 muaj , me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Orari i punës: I plotë.

Kualifikimi i kërkuar : Shkolla fillore apo e mesme.

Patent Shoferi – Kategoria B

I përgjigjet për punën e tij : Udhëheqësit të njësisë për mirëmbajtje të ndriqimit publik në Komunën e Pejës .

Përparësi kanë kandidatet të cilët posedojnë certifikatë mbi aftësimin profesional për pozitën në fjalë.

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Mirëmbajtjen dhe kujdesin e shtyllave të ndriqimit publik në të gjithë territorin e Komunës së Pejës.
- Zëvendësimin dhe ndërrimin e poqëve ndriçuese ose llambave të dëmtuara për të siguruar ndriçim të përshtatshëm dhe siguri në hapësirat publike.
- Rregullimin dhe vlerësimin e gjendjes së shtyllave elektrike në rrugët e caktuara;
- Koordinim me ekipet e instalimit të shtyllave elektrike për ndërhyrje të reja ose përmirësime të infrastrukturës ekzistuese;
- Rregullimin e defekteve eventuale në të gjitha objektet Komunale.
- Përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të sigurta sikurse Krani për ekzekutimin e ndërhyrjeve dhe kujdesit të shtyllave elektrike.
- Projektimin, organizimin dhe realizimin e dekorimit të qytetit për festat zyrtare, dhe festa të tjera të caktuara nga Komuna e Pejës. Komuna është përgjegjëse për sigurimin e të gjitha materialeve, pajisjet dhe burimet që janë të nevojshme për të kryer punën e dekorimit, duke siguruar që ato janë të cilësisë së duhur dhe në përputhje me kërkesat e Komunës së Pejës;
- Ngritjen e veprimeve të menjëhershme për të adresuar raste të jashtëzakonshme, siç janë vërshimet e rënda, rënia e pemëve ose raste të tjera emergjente që mund të ndikojnë në sigurinë dhe qarkullimin e qytetarëve;
- Të përcaktoj procedurat e nevojshme për t'u përballur me raste të jashtëzakonshme jashtë orarit të punës dhe ta bëjë sigurimin e personelit dhe mjeteve të nevojshme për të kryer intervenimet e tilla;

Pozita : Pastrues/e (1) vende të lira :

- Një (1) Pastrues/e në SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

Kohëzgjatja: periudhë provuese 6 muaj , me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Orari i punës: I plotë.

Kualifikimi i kërkuar : Shkolla fillore apo e mesme.

I përgjigjet për punën e tij : Udhëheqësit të njësisë për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Detyrat dhe përgjegjësit :

- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përgjithshme higjienike e zyrave të punës të ndërtesës administrative dhe operative;
- Kujdesi në mënyrë të veçantë për pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike të pastërtisë, të mureve, dritareve, dyshemesë dhe inventarit-mobileve në zyrë etj.;
- Pastrimin dhe dezinfektimin e WC-ve, po ashtu largon pluhurin nga inventari, barte mbeturinat, letrata përdorura etj;
- Bene ajrosjen e zyrave, mirëmban dhe ujite lulet, pastron oborrin përpara, mbrapa dhe rreth objektit;
- Mirëmban pajisjet për pastrimin e objektit;
- Si dhe detyrat tjera të cilat (me tutje) mund të jenë të bashkangjitura në përshkrimin e detyrave të punës ose të caktuara nga punëdhënësi;

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kandidati-ja që konkurron për pozitat e lartcekura duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin (duke specifikuar qartë pozitën në të cilën aplikoni), i cili merret në zyrat e ndermarjes NPL "Eko-Sig" SH.A me adresë në ish-objektin i QMF "Karagaç" në Pejë.
- Dëshmia e përfundimit të shkollimit të kërkuar . (Diploma në origjinal ose kopje e noterizuar)
- Certifikatën që nuk është nën hetim (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Certifikatën mjeksore.
- Kopjen e Letërnjoftimit.
- Kopjen e Patent-shoferit (për pozitën ndihmës-elektricitist)

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga data e publikimit 15.09.2025 dhe mbetet i hapur deri me datën 29.09.2025. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Aplikacionet me dokumentet përcjellese, dorëzohen dhe prahen të kompletuara në pliko (zarf) NPL "Eko-Sig" SH.A me adresë në ish-objektin i QMF "Karagaç" në Pejë. Për info shtesë mund të kontaktoni sekretarinë e ndermarjes në nr të tel. 049-199-320.

Kandidatët të cilët konkurronë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.